VENDIM
Nr. 825, datë 18.12.2019

PËR SUBVENCIONIMIN E DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJTARISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 70/2016, "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, për një periudhë njëvjeçare, në masën 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga shpenzimet korrente në programin "Tregu i punës", miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama